



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 50 / Prot.
17

Tiranë, më 29, 02 2024

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për vitin 2023.

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
DREJTORISË SË MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të vitit 2023 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ardian Myslimaj



HYRJJE

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të vitit 2023, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Në vijimësi dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027.

Në mbështetje të Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” të ndryshuar me akte normative, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për vitin 2023, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2023-2025 dhe është në funksion të kësaj Deklarate. Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integritimit Evropian.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2023”

Bazuar në Ligjin 84/2022, datë 25.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, KLSH për vitin 2023 u miratua fondi në total në vlerën **509,100 mijë lekë**, nga të cilat 486,100 mijë lekë për shpenzime korente dhe 23,000 mijë lekë për Shpenzime Kapitale nga të cilat 20,000 mijë lekë me Financim të Brendshëm dhe 3,000 mijë lekë me Financim të Huaj. Ky buxhet, në muajin Qershor 2023 është shtuar në vlerën për 150,000 mijë lekë nga Fondi Rezervë me qëllim përballimin e efekteve financiare për shtesën e pagave të nëpunësve, dhe në muajin dhjetor nga Fondi i Veçantë në vlerën për 1,100 mijë lekë me qëllim zbatimin e VKM nr. 795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me bashkimin evropian”. Me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023 buxheti i KLSH-së ka pësuar ndryshime duke kaluar kështu në vlerën totale për **561,700 mijë lekë**.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

Artikulli	Pershkrimi	Fakti 2022	Ligji Buxhetit V.2023	VKM	Akti Normativ 2023	Fondi i Veçantë	Plan Buxheti 2023	Në mijë lekë	
								Fakti 2023	%
				1	2	3	4=1+2+3		
600	Paga	290,957	351,300	120,000	283,300	1,100	404,400	402,587	100%
601	Sigurime Shoqërore	47,126	46,800	30,000	33,800		63,800	62,524	98%
600+601	Shpenzime për paga	338,083	398,100	150,000	317,100	1,100	468,200	465,111	99%
602	Mallra dhe Shërbime	72,158	87,850		75,850		75,850	71,424	94%
605	Transferta		150		150		150	116	77%
602-605	Shpenzime Korente	72,158	88,000	0	76,000		76,000	71,540	94%
231	Kapitale të Trupëzuara	13,032	15,000		9,500		9,500	6053	64%
230	Kapitale të Pa Trupëzuara	4,291	5,000		5,000		5,000	1,816	36%
231	Financim i Brendshëm	17,323	20,000	0	14,500		14,500	7,869	54%
230	Financim i Huaj		3,000		3,000		3,000	7,317	
	Totali	427,564	509,100	150,000	410,600	1,100	561,700	551,837	98%

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR VITIN 2023

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në Ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për zërin “Paga dhe Sigurime” është në vlerën për 398,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve është 243 punonjës. Ky buxhet është shtuar në vlerën për 150,000 mijë lekë nga Fondi Rezervë dhe 1,100 mijë lekë nga Fondi i Veçante i Qeverisë me qëllim përballimin e efekteve financiare për shtesën e pagave të nëpunësve të akorduar nga qeveria, si dhe me qëllim ekzekutimin e VKM nr. 795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me bashkimin evropian”.

Me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023, **plani i buxhetit** për paga dhe sigurime ka pësuar ndryshime duke kaluar kështu në vlerën totale për **468,200 mijë lekë**.

Për vitin 2023, buxheti i planifikuar është realizuar në vlerën për **465,111 mijë lekë** ose realizuar në masën 99%. Shuma e shpenzuar në zërin “Paga dhe Sigurime”, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në Ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 88,000 mijë lekë, ose 17 % e planit buxhetor të vitit 2023.

Plani për vitin 2023 në vlerën për **76,000 mijë lekë** është realizuar në vlerën për **71,540 mijë lekë**, ose realizuar në masën 94%.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në funksion të veprimtarisë auditueses vlerën për 47,004 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 65.2% të shpenzimeve faktike korentë. Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete është e shoqëruar me kosto përkatëse duke u fokusuar në menaxhimin sa më të kujdesshëm dhe efektiv të fondeve buxhetore.

Aktualisht, për vitin 2023, KLSH , ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

-Rinovim suporti të licenca të Firewall dhe E-Mail Security. Prokurimi i rinovimit të licencave të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Blerje karburanti për automjetet, shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, sistem alarmi, shërbim automjetesh.

3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2023, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 126 mijë lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara.

4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2023, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,600 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje. Për vitin 2023, ky zë është realizuar në vlerën për 643 mijë lekë.

5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 23,000 mijë lekë, nga të cilat 20,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm dhe 3,000 mijë lekë për investime kapitale me

Financim të Huaj. Me Aktin Normativ. Nr.6, datë 14.12.2023 plani i buxhetit për investimet kapitale me financim të brendshëm është pakësuar në vlerën për 5,500 mijë lekë duke arritur kështu në vlerën për 14,500 mijë lekë.

Për vitin 2023, buxheti i planifikuar në masën për 14,500 mijë lekë është realizuar në vlerën për 7,870 mijë lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Artikulli	KOD	Pershkrimi	Plan Buxheti 2023	Fakti 2023	Diferenca	%
231	M240009	Pajisje informatike	3,400,000	2,228,863	1,171,137	66%
231	M240010	Pajisje zyre	5,400,000	3,190,999	2,209,001	59%
230	19AA402	Kosto Lokale	5,000,000	1,816,700	3,183,300	36%
231		Rikonstrukcion ndërtesa	700,000	633,600	66,400	91%
231		Totali	14,500,000	7,870,156	6,629,844	46%

-Për vitin 2023, plani i buxhetit në zërin Paisje zyre dhe Rikonstrukcion ndërtesa në vlerën për 6,100 mijë lekë konsiston në riorganizimin e ambienteve të brendshme të KLSH-së dhe konkretisht në kryerjen e punimeve të ndërtimit në vlerën për 700 mijë lekë dhe arredim të brendshëm me mobilim (furnizim-vendosje) në vlerën për 3,800 mijë lekë. Adresimi i fondeve të investimeve në këtë projekt investimi ka ardhur si domosdoshmëri, pasi salla ekzistuese e mbledhjeve nuk i përmbush kërkesat e një standardi të punës dhe prezantimin dinjitoz si institucion suprem auditimi, që të jetë në nivelin e kërkesave të kohës, kjo pasi pjesa më e madhe e pajisjeve ekzistuese të saj thjesht janë përshtatur për ambientin, apo janë të amortizuara. Ky projekt parashikon kryerjen e punimeve të brendshme të godinës si dhe në blerjen e pajisjeve të reja funksionale si tavolina, karrige, projektor, etj.

-Në zërin “Pajisje informatike”, KLSH, ka prokuruar fondet për blerjen e pajisjeve informatike kompjuterike, në funksion të veprimtarisë audituese. Për vitin 2023, ky zë i planifikuar në vlerën për 3,400 mijë lekë është realizuar në masën për 2,229 mijë lekë ose në masën 66% te planifikuar.

-Plani i buxhetit në zërin “Kosto lokale”, në vlerën për 5,000 lekë dhe që i përket shpenzimeve për projektin e investimit “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Për vitin 2023, ky zë është realizuar në masën për 1,817 mijë lekë.

B-Financim i Huaj

Bazuar në Ligjin nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 230 është miratuar në vlerën **3,000 mijë lekë** dhe është parashikuar për zbatimin e projektit, “**Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri**”. Për vitin 2023, ky projekt është realizuar në vlerën për **7,317 mijë lekë**.

Bashkëpunimi mes KLSH-së dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) i Konfederatës zvicerane do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së, por do të jetë njëkohësisht edhe promotori i mbështetjes së Konfederatës së Zvicrës për Republikën e Shqipërinë.

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kontributit të KLSH-së për të forcuar llogaridhënien qeveritare në përdorimin e fondeve publike përmes auditimeve më profesionale dhe gjithëpërfshirëse të prokurimeve publike, koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, duke përdorur mjete IT në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira profesionale për sektorin publik.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet

publike-private (PPP). Ky projekt do të bëjë të mundur krijimin e eksperiencave të reja dhe do të përsosë njohuritë dhe aftësitë e audituesve të KLSH-së për të mbikëqyrur fushën e koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik-privat duke sjellë dhe plotësimin e një kornize të përshtatshme për të siguruar që këto lloj kontratash ofrojnë vlerë të shtuar dhe minimizojnë risqet në kushtet e financimit publik. I gjithë ky proces nuk mund të bëhet pa garantuar që audituesit kanë aftësitë e duhura teknike lidhur me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në auditim. Projekti do të mundësojë auditime më cilësore dhe do të japë rekomandime me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publike përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Ky projekt dy vjeçar do të ndihmojë dukshëm në drejtim të auditimit më profesional të fondeve publike në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TË KLSH-SË, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PER PERIUDHEN E VITIT 2023

KLSH përgjatë vitit 2023 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përnibushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të iniciativave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Misioni

Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikën me të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Vizioni

KLSH synon të jetë një institucion profesional i besueshëm që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.

Objektivat:

Tre qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme janë:


1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.
2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MENAXHIMIT INSTITUCIONAL.

Kontrulli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – dhjetor 2023, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 234 datë 16.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së, duke kryer dhe evaduar 160 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet si më poshtë:

- 68 auditime të kombinuara
- 46 auditime përputhshmërie
- 7 auditime financiare
- 17 auditime performance
- 14 auditime tematike
- 8 auditime IT

Grafik nr.1 Llojet e auditimeve



Burimi: KLSH

Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit te auditimit

Bazuar në planin vjetor 2023, Kontrulli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar-dhjetor 2023, ka përfunduar kryerjen e 160 auditimeve, duke dhënë:

- 51 opinione për 53 auditime, nga të cilat 7 financiar, 46 përputhshmëri dhe 127 opinione për 68 auditimet e kombinuara
- 16 mesazhe auditimi për 17 auditimet e performancës
- 14 konkluzione, nga të cilat: 8 për 8 auditimet IT, 1 për auditimet financiare, 3 për auditimet e kombinuara, 1 për auditimet e përputhshmërisë dhe 1 për auditimin tematik.

Tabela nr.1 Opinioni/mesazhi/konkluzioni sipas llojit te auditimit

Lloji i auditimit	I modifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I modifikuar	Konkluzioni	Mesazhi	Total
Financiar	4	2				1	7
I kombinuar	46	16	3	62		3	130
IT						8	8
Performance			7	38		16	16
Përputhshmërie						1	46
Tematik						1	1
Total	50	18	10	100		14	208

Në përfundim të misioneve të auditimit, bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesit është konkluduar me dhënien e Opinioneve të Auditimit mbi pasqyrat financiare të subjektit të audituar dhe mbi përputhshmërinë e aktivitetit¹. Mbështetur në

¹ Bazuar në Manualin e Auditimit Financiar dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë

standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 100), në baze të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinioni i dhënë mund të jetë “i modifikuar” ose “i pamodifikuar”.

Opinionet e pamodifikuar mund të jenë:

- Të pakualifikuar
- Të pakualifikuar me theksim çështje

Opinionet e modifikuar mund të jenë:

- Të kualifikuar
- Të kundërt
- Refuzues

Auditimet kanë përfshirë institucione të qeverisjes qendrore: ministri dhe agjenci përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre²; njësi të vetëqeverisjes vendore: qarqe dhe bashki; institucione që administrojnë fonde speciale: ISSH dhe FSDKSH, institucione të pavarura; shoqëri aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.



Puna audituese është përqendruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe gjatë kësaj periudhe, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe ineficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkeljet në zbatimin e legjislacionit fiskal.

Duhet theksuar se me impakt janë edhe shkeljet e lidhura me shkeljet në programimin, implementimin dhe zbatimin e kuadrit fiskal. Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2021-2022 përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

Rezultatet e veprimtarisë audituese të vitit 2023 kanë pasur objektiv që krahas masave organizative për përmirësimin e situatës, edhe identifikimin e shkeljeve dhe raportimin e tyre në bazë të klasifikimit si dëm ekonomik³ dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në financat publike nga aktiviteti i subjekteve nën auditim⁴. Parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara, i referohen:

- Përdorimit të fondeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në fushën e prokurimit publik për shkak të mungesës së kontrollit në realizimin e këtyre procedurave, të cilat në shumë raste rezultojnë të kryera jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Shkelje të disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike, likuidimin e faturave për shpenzime/investime, i cili është shoqëruar me krijimin e detyrimeve të prapambetura;
- Parregullsitë dhe shkeljet në administrimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore;
- Keqadministrimin e pronës shtetërore.

Shënim: Informacion i detajuar mbi veprimtarinë e KLSH, jepet në Raportin Vjetor të Performancës së institucionit.

² Drejtori të administrimit fiskal dhe doganor.

³ Dëmi ekonomik referohet detyrimit të shpërblimit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet entit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrit rregullator përkatës.

⁴ Efekti negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Mbi trajnimet e realizuara gjatë vitit 2023.

Trajnimi dhe zhvillimi i audituesve, është një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, drejt kapaciteteve audituese. KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të KLSH-se, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, në bashkëpunim kjo me partnere të brendshëm dhe të jashtëm si: SAI-et homologe, INTOSAI, EUROSAI, SIGMA, ASPA, OSBE, ANAC, SECO etj.

Treguesit kryesorë të zhvillimit profesional dhe trajnimit në KLSH -së për vitin 2023:

Mbi trajnimet e realizuara gjatë vitit 2023.

Referuar Plan -Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së” për vitin 2023, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.07 datë 13.01.2023, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, janë zhvilluar trajnime me prezencë fizike dhe online në platformën Microsoft skype me stafin e KLSH-së, Webinare dhe kurse online pranë ASPA-s, dhe trajnime (Workshop, konferenca online, takime) me Organizata dhe Partnerë Ndërkombëtarë. Nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, KLSH ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave për përmirësimin e cilësisë së punës audituese në funksion të rritjes së transparencës, mirëqenies dhe përdorimit të parasë publike, dhe rritjen e besimit të publikut dhe palëve të jashtme tek KLSH.

KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të KLSH-së, si prioritet kryesor për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, kjo në bashkëpunim dhe me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm si SAI-et homologe, INTOSAI, EUROSAI, SIGMA, ASPA, OSBE, ANAC, SECO etj.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2023, u realizuan gjithsej 207 tema trajnimesh, nga të cilat: 108 tema nga KLSH dhe 99 tema nga ASPA dhe partnerë ndërkombëtarë si EUROSAI, IDI, ECA, GAO, SAI i Norvegjisë, ANAC, OECD, etj.

U trajnuan në total gjithsej 196 auditues dhe jo-auditues, duke realizuar në total 4854 ditë-njerëz trajnime, nga të cilat 4465 ditë trajnime për 168 staf auditues dhe 389 ditë trajnime për 28 staf jo-auditues; ose realizuar mesatarisht rreth 27 ditë trajnimi/auditues dhe jo-auditues, (nga 20-25 ditë trajnimi për auditues që është objektivi vjetor, dhe 14 ditë trajnimi për staf jo-auditues).

Referuar trajnimeve të brendshme në KLSH bazuar në Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së” për vitin 2023, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.07 datë 13.01.2023 dhe Plan-Veprimit në zbatim të këtij të fundit, vlen të përmendim se gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, janë 196 auditues dhe jo auditues në KLSH (168 auditues dhe 28 jo auditues) që kanë marrë pjesë në mënyrë të koordinuar në 55 tema trajnimesh dhe kanë realizuar një numër prej 2660 ditë/auditues trajnimi.

Trajnimet e brendshme të KLSH kane patur ne fokus:

- Trajnime didaktike (Të realizuara nga Dep. i Metodologjisë dhe eksperte të jashtëm);
- Shkëmbime njohurish dhe eksperiencash nga trajnerët e brendshëm (si psh auditimi me i mire për vitin 2023, eksperiencia në përditësimin e manualeve të auditimit etj);
- Prezantime të auditimeve me impakt të lart për opinionin publik;
- Trajnime për sistemet IT nga trajner të brendshëm dhe të jashtëm.

Për vitin 2023, partneret e KLSH kane gene si me poshtë

- ✓ KLSH me 2660 dite/njerëz trajnim

- ✓ ASPA me 1065 dite/njerëz trajnim
- ✓ Ndërkombëtar me 999 dite/njerëz trajnim
- ✓ Vendas me 130 dite/njerëz trajnim

Krahas trajnimeve të Brendshme KLSH ka vijuar edhe për vitin 2023 bashkëpunimin e saj me Shkollën e Administratës Publike (ASPA) duke përcjellë elektronikisht përgjatë muajve janar-dhjetor 2023 kalendarët e trajnimeve online (Webinar dhe kurse online) tek stafi i KLSH-së. Shpërndarja e trajnimeve bëhet duke patur parasysh formimin e audituesve, por veçanërisht angazhimin e tyre varësisht departamenteve ku janë pjesë. Tematikat që dominojnë janë: Prokurimi publik, Ligji për nëpunësin civil dhe të drejtën administrative, Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli, Auditimi Brendshëm, Vetëqeverisja vendore, E drejta Europiane, Fondet IPA, Siguria e Informacionit, komunikimi, etika dhe niveli menaxherial, programi i kontrollit dhe cilësisë në auditim, auditimi publik, kontabiliteti dhe statistikat etj.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, janë trajtuar nga ASPA 108 tema me 1195 ditë njerëz trajnimi. Gjithashtu gjatë vitit 2023, janë trajtuar 22 tema kurs me certifikim me pjesëmarrjen e 21 audituesve ose rreth 232 ditë njerëz trajnimi.

Llojet e trajnimeve 2023: Lidhur me llojet e trajnimeve të zhvilluara gjatë periudhës janar – dhjetor 2023 janë sipas tabelës më poshtë:

Nr. rendor	Lloji trajnimit	Ditë trajnime
1	Fellowship	86
2	Internship	220
3	Konferencë	7
4	Kurs me certifikim	232
5	Seminar	34
6	Trajnim	2577
7	Webinar	852
8	Workshop	846
	Total	4854

Trajnimet sipas tipologjisë (tema trajnimi online dhe fizik)

Gjatë këtij viti, u realizuan tema trajnimi online dhe fizik, nga të cilat, 3038 ditë/njerez trajnimi me paraqitje fizike në trajnim dhe 1816 dite/njerëz trajnimi online nëpërmjet platformës skype.

Një informacion më i detajuar në lidhje me veprimtarinë e kryer për vitin 2023, jepet në Buletinin Statistikor, i cili publikohet në faqen web të KLSH-së.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ardian Myslimaj




ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periudha e Raportimit 12-2023

në/lekë

Emri i Grup Kontrolli Lartë i Shtetit		Kodi i grupit										11 (9/5)
		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
Kodi i Program	Emërtimi	Viti paraardhës 2022		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rëthikuar Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	(10 (5-4))	(11 (9/5))		
EMËRTIME												
Shpenzimet sipas programeve buxhetore												
Emërtimi												
01120	Vepimtaria Audituese e KLSH	427,563,891.00	100	509,100,000.00	100	563,300,000.00	100	552,481,200.90	100	10,818,799.10	98	
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01,02,03,04,05,06,22)		427,563,891.00	100	509,100,000.00	100	563,300,000.00	100	552,481,200.90	100	10,818,799.10	98	
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0.00						0.00				
Totali Shpenzimeve të Ministrisë		427,563,891.00						552,481,200.90				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Emërtimi												
600	Paga	290,957,027.00	68	351,300,000.00	69	404,400,000.00	72	402,586,583.00	73	1,813,417.00	100	
601	Sigurime Shoqërore	47,125,747.00	11	46,800,000.00	9	63,800,000.00	11	62,524,010.00	11	1,275,990.00	98	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	68,484,587.00	16	88,000,000.00	17	75,850,000.00	14	71,423,959.90	13	4,426,040.10	94	
603	Subvencione	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	
605	Transferta Korente të Huaja	119,769.00	0	0.00	0	150,000.00	0	116,035.00	0	33,965.00	77	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,553,782.00	1	0.00	0	1,600,000.00	0	643,117.00	0	956,883.00	40	
Non-Totali Shpenzime Korrente		410,240,912.00	96	486,100,000.00	96	545,800,000.00	97	537,293,704.90	97	8,506,295.10	98	
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,291,120.00	1	0.00	0	5,000,000.00	1	1,816,700.00	0	3,183,300.00	36	
231	Kapitale të Trupëzuara	13,031,859.00	3	20,000,000.00	4	9,500,000.00	2	6,053,456.00	1	3,446,544.00	64	
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem		17,322,979.00	4	20,000,000.00	4	14,500,000.00	3	7,870,156.00	1	6,629,844.00	54	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	7,317,340.00	1	-7,317,340.00	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	3,000,000.00	1	3,000,000.00	1	0.00	0	3,000,000.00	0	
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj		0.00	0	3,000,000.00	1	3,000,000.00	1	7,317,340.00	1	-4,317,340.00	244	
Totali Shpenzime Kapitale		17,322,979.00	4	23,000,000.00	5	17,500,000.00	3	15,187,496.00	3	2,312,504.00	87	
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor		427,563,891.00	100	509,100,000.00	100	563,300,000.00	100	552,481,200.90	100	10,818,799.10	98	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)		0.00						0.00				
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga te ardh. jashte limiti		427,563,891.00										
Numri i punonjësve		0		0		0		0		0		



 Arditur Shyqiriy

 12.09.2023

Emri
 Firma
 Data

Sekretari i Përgjithshëm